



Apple, BlackBerry, Samsung, dhe kompani të tjera kanë nxjerrë celularë të zgjuar të

fuqizuar nga sisteme operative si Android, Symbian, iOS, etj., që na lejojnë të luajmë lojra, të dëgjojmë audio, të shikojmë video, të marrim foto, dhe të shfletojmë internetin.

Gjithë këto funksione që përmban një celular 'smartphone' vijnë me një çmim për të paguar: bateria. Bateria e këtyre celularëve nuk zgjat shumë. E shumta që mund të shikojë një bateri e një 'smartphone'-i është dy ditë, para se të nevojitet karikim.

Sot kemi mbledhur për ju një listë të disa gjërave që janë në dorën tuaj për të mirëmbajtur dhe për të zgjatur 'jetën' e një baterie vetëm me një karikim.

1. Mbyll dritshjet

Dritshjet janë një mënyrë e shkëlqyeshme për t'ju njoftuar ju për thirrjet apo mesazhet kur jeni në kinema, në një mbledhje, në kishë/xhami, etj. Por a dini ju se dritshjet përdorin më shumë bateri se zilet normale (ringtones)? Pra n.q.s. Keni mundësi, dhe

nuk jeni në ndonjë vënd me rëndësi, mbyllja e dritshjeve do t'ju kursejë ju shumë bateri.

2. Errëso ekranin

Errësimi i ekranit të celularit ndihmon në ruajtjen e baterisë drastikisht. Errësimi i ekranit lejon që celulari të përdorë më pak bateri për të funksionuar. Shumë celularë modernë kanë një veçuri të quajtur 'Auto-Brightness' që e çon errësimin sipas ambientit ku ndodheni.

3. Mbyll celularin

Edhe pse startimi i një celulari përdor shumë bateri, mbyllja komplet e celularit ndihmon në kursimin e kësaj të fundit. N.q.s je në gjumë p.sh., dhe nuk pret ndonjë telefonatë të rëndësishme, rekomendohet mbyllja e celularit. Sepse edhe kur nuk është duke u përdorur, një celular i 'zgjuar' është duke përdorur baterinë vazhdimisht për programet aktive.

4. Karikoni si duhet

Kur vjen puna tek karikimi i celularit, bateritë janë të dy lloji: Lithium-ion(Li-Ion), dhe Nickel-based. Kapaciteti në bateritë Nickel-based (NiCd) bie sa herë që karkikohet bateria. Këto bateri duhen karikuar kur ka ngelur vetëm pak, p.sh. kur je tek 10% e poshtë. N.q.s keni rreth 40%, nuk është mirë që të karikoni këto lloj baterish.

Bateritë Li-Ion në anën tjetër zgjatin më shumë, por duhen karikuar sa më shpesh, edhe kur niveli i baterisë mund të jetë në 40%. Kështu që hidhini një vështrim llojit të baterisë që përdor celulari juaj, dhe mësohuni si t'a ruani atë.

5. Mbyll aplikacionet e panevojshme

Në hapim aplikacion pas aplikacioni kur përdorim celularët, dhe harrojmë t'i mbyllim këto aplikacione. Aplikacionet që janë aktive, por që ti nuk i shef, e kanë qejf përdorimin e shumtë të baterisë, prandaj është gjithmonë mirë që pasi të kesh mbaruar

me një aplikacion, t'a mbyllësh atë.

6. Ç'aktivizo GPS-in

Aplikacionet që përdorin veçorinë e GPS-së përdorin më shumë bateri se aplikacionet që nuk e bëjnë këtë gjë. N.q.s ndiheni se një "check-in" në Facebook për të njoftuar shokët se je tek biloku është absolutisht i nevojshëm, atëherë mirë. Por n.q.s

këto "check-in"-e nuk janë me shumë rëndësi për ty, atëherë ç'aktivizimi i GPS-së ju ndihmon shumë në ruajtjen e baterisë.

7. Jo Bluetooth, Wi-Fi, 3G kur është e mundur

Sa herë që celulari juaj kërkon për sinjale, si p.sh. Bluetooth, Wi-Fi, apo 3G, ai konsumon bateri. Kur nuk ke shumë valë, atëherë celulari përpiqet që të marrë një sinjal më të fortë, prandaj bateria juaj konsumohet më shumë. Shumë celularë modernë

kanë një veçori të quajtur 'Airplane Mode', e cila mbyll të gjitha lidhjet, si p.sh. ato të lartpërmendura.

Por mbyllti të gjitha lidhjet vetëm kur është e mundur, jo gjithmonë, sepse nuk merr dot thirrje apo mesazhe në atë mënyrë.

8. Minimizo njoftimet

Shumë aplikacione dërgojnë njoftime në celularin tuaj, p.sh. kur njëri komenton në statusin tënd në Facebook, apo kur merr një email në Gmail. Këto njoftime nuk janë shumë të nevojshme zakonisht, prandaj heqja e tyre do t'ju kursëjë shumë bateri.

9. Temperatura të freskëta

Si të mirëmbajmë baterinë e celularit

Krijuar: Merkure, 22 Gusht 2012 22:21

E lehtë fare! Mos e vendos celularin në diell direkt ose në vënde të nxehta. Nxehtësia konsumon shumë baterinë tuaj.

Tech.All